

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I  
Z Y R T A R

---

vëllimi 26 numër 8 nëntor 2024

Data e botimit: 04.12.2024



P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 52, datë 6.11.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut operacional""	5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 53, datë 6.11.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar""	16
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 54, datë 6.11.2024 "Për miratimin e rregullores "Mbi kriteret dhe metodikën për caktimin e çmimeve të shitjes së artikujve numizmatikë për shitje""	19
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 56, datë 6.11.2024 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (EIB)"	27
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 57, datë 6.11.2024 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 81, datë 15.11.2006 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar""	28
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 58, datë 20.11.2024 "Për miratimin e "Strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2025-2027"	33
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 61, datë 20.11.2024 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 24.1.2024 "Për rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 50 Lekë dhe 20 Lekë"	35
8. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot 4790, datë 21.11.2024 "Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarive shtesë të shërbimit të inicimit të pagesës dhe të shërbimit të informimit të llogarisë nga institucioni i parasë elektronike "Easypay" sh.p.k."	37
1. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 1, janar 2024	39
2. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 2, shkurt 2024	39
3. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 3, prill 2024	40
4. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 4, qershor 2024	40
5. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 5, korrik 2024	41
6. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 6, gusht 2024	41
7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 7, nëntor 2024	41





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM  
Nr. 52, datë 6.11.2024

**PËR**  
**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN**  
**“PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT OPERACIONAL”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të neneve 60, 62 dhe 65, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut operacional”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 19.1.2011, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) Titulli i rregullore ndryshon si vijon:  
*“Për administrimin e rrezikut operacional nga subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”;*
  - b) Përmbajtja e nenit 1, ndryshon si më poshtë:  
*“Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave dhe rregullave për administrimin e rrezikut operacional nga subjektet e kësaj rregulloreje.”;*
  - c) Në nenin 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
    - i. në shkronjën “b”, hiqet togfjalëshi “nenit 57, pika 4 dhe nenit 58, pika 1, shkronja “c” dhe”,
    - ii. përmbajtja e shkronjës “c”, ndryshon si më poshtë:

"c) neneve 60, 62 dhe 65, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre".";

d) Në nenin 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. përmbajtja e pikës 1 ndryshon si më poshtë:

"1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë subjektet financiare jobanka, si dhe shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.",

ii. pas pikës 1, shtohen pikat 2 dhe 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

"2. Banka e Shqipërisë, bazuar në vlerësimet e saj mbikëqyrëse lidhur me volumin dhe kompleksitetin e veprimtarisë, apo nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut operacional, mund të vendosë që subjekte financiare jobanka apo shoqëri kursim-krediti të caktuara, që janë subjekte të kësaj rregulloreje, të bëhen subjekte të rregullores "Për administrimin e rrezikut operacional nga bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike".

3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë njofton subjektin financiar jobankë apo shoqërinë e kursim-kreditit, si dhe përcakton afatin kohor brenda të cilit subjekti duhet të sigurojë plotësimin e kërkesave të rregullores "Për administrimin e rrezikut operacional nga bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike".";

e) Në nenin 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, togfjalëshi "ligjin nr. 8782, datë 3.5.2001, "Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit", i ndryshuar", zëvendësohet me togfjalëshin "ligjin nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre",

ii. pika 2 shfuqizohet,

iii. në pikën 3, përmbajtja e shkronjave "c" dhe "d", ndryshon si më poshtë:

"c) "rezik strategjik" - është mundësia që të cenohet arritja e objektivave strategjike të subjektit, me pasojë fundore humbje financiare, për shkak të ndryshimeve në mjedisin e biznesit dhe nga vendimet e papërshtatshme të biznesit, zbatimi i gabuar i vendimeve ose mungesa e reagimit ndaj ndryshimeve në mjedisin e biznesit;

d) "rezik reputacional" - është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare të shkaktuara nga perceptimi negativ nga ana e klientëve, kundërpasive, aksionerëve, investitorëve, mbajtësve të borxhit, tregjeve, palëve të tjera të interesit, rregullatorëve etj., që mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e subjektit për të vazhduar të operojë/funksionojë apo për të krijuar marrëdhënie të reja biznesi dhe për të pasur akses të vazhdueshëm në burime

*financimi (p.sh. nëpërmjet tregjeve ndërbankare, të kapitalit dhe borxhit apo në publikun e gjerë);",*

- iv. në pikën 3, pas shkronjës "d", shtohet shkronja "e" me përmbajtjen e mëposhtme:
- "e) *"marrëveshje me të tretët (outsourcing)" - është një marrëveshje e çdo forme ndërmjet subjektit dhe një pale të tretë (ofruesi shërbimi), sipas së cilës pala e tretë (ofruesi i shërbimit) kryen një proces, një shërbim ose një funksion, që në rast të kundërt do të kryhej nga vetë subjekti."*
- f) Në nenin 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 1, fjala "teknika" zëvendësohet me fjalën "mekanizma" dhe pas togfjalëshit "vlerësimin, kontrollin", shtohet fjala ", raportimin",
- ii. në pikën 2, shkronja "b", fjala "rreziqe" zëvendësohet me fjalën "humbje" dhe togfjalëshi "(duke përfshirë ato të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje)", zëvendësohet me togfjalëshin ", duke konsideruar edhe shembujt e ngjarjeve të rrezikut operacional të parashikuara në aneksin nr. 7 të kësaj rregulloreje",
- iii. në pikën 2, shkronja "c", pas togfjalëshit "vlerësimin, monitorimin", shtohet fjala ", raportimin";
- g) Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. titulli i nenit ndryshon në "Përgjegjësitë e këshillit të administrimit/mbikëqyrës/drejtues",
- ii. në pikat 1, 2 dhe 3, togfjalëshi "Këshilli Drejtues", zëvendësohet me togfjalëshin "Këshilli i administrimit/mbikëqyrës/drejtues",
- iii. në pikën 2, shkronja "a", togfjalëshi "miratimin e politikave dhe procedurave përkatëse" zëvendësohet me togfjalëshin "miratimin e politikave përkatëse";
- h) Në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. titulli i nenit ndryshon në "Përgjegjësitë e administratorit/administratorëve",
- ii. në pikën 1, togfjalëshi "Drejtoria është përgjegjëse" zëvendësohet me togfjalëshin "Administratori është përgjegjës" dhe togfjalëshi "Këshilli Drejtues" zëvendësohet me togfjalëshin "këshilli i administrimit/mbikëqyrës/drejtues",
- iii. në pikën 2, togfjalëshi "Drejtoria, në funksion të administrimit të rrezikut operacional, është përgjegjëse për:", zëvendësohet me togfjalëshin "Administratori, në funksion të administrimit të rrezikut operacional, është përgjegjës për:",
- iv. në pikën 2, shkronja "e", hiqet togfjalëshi "bankare dhe/ose",
- v. në pikën 2, shkronja "g" shfuqizohet;
- i) Në nenin 8, pika 5, ndryshon si më poshtë:

*"5. Subjektet përcaktojnë metodat dhe teknikat e tyre për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut operacional, duke konsideruar edhe metodat dhe teknikat që subjektet mund të përdorin për administrimin e rrezikut operacional, të parashikuara në aneksin nr. 6 të kësaj rregulloreje."*

- j) Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 2, shkronja "d", togfjalëshi "drejtorinë dhe këshillin drejtues" zëvendësohet me togfjalëshin "administratorin dhe këshillin e administrimit/mbikëqyrës/drejtues",
  - ii. në pikën 3, togfjalëshi "drejtorinë dhe këshillin drejtues" zëvendësohet me togfjalëshin "administratorin dhe këshillin e administrimit/mbikëqyrës/drejtues";
- k) Në nenin 10, pika 2, shkronja "h", togfjalëshi "transferimi i funksioneve dhe/ose përgjegjësive të subjektit të palët e treta.", zëvendësohet me togfjalëshin "transferimi i proceseve, shërbimeve ose funksioneve të subjektit të palët e treta (outsourcing).";
- l) Përmbajtja e nenit 12, ndryshon si më poshtë:
- "Subjektet raportojnë në Bankën e Shqipërisë çdo tre muaj, të dhënat sipas anekseve nr. 1 dhe nr. 3 të kësaj rregulloreje."*
- m) Në nenin 13, togfjalëshi "ligjin "Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit.", zëvendësohet me togfjalëshin "ligjin "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre".";
- n) Anekset 1-7 të rregullores, zëvendësohen me anekset nr.1 - nr.7, me përmbajtjen sipas anekseve bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 1 mars 2025.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**



## ANEKSET

Për raportimin e treguesve të paralajmërimit të hershëm në Bankën e Shqipërisë, subjekti plotëson aneksin nr. 1, duke ndjekur udhëzimet e parashikuara në aneksin nr. 2 të kësaj rregulloreje.

### ANEKSI NR. 1 TREGUESIT E PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM

Nr.	Treguesi	Vlera	Komente
1	Numri i çështjeve të reja ligjore	Numër	
2	Kostoja e çështjeve ligjore	Vlerë (ALL)	
3	Ankesat e reja të klientëve	Numër	
4	Ankesat e hapura të klientëve	Numër	
5	Numri i gjobave nga autoritetet	Numër	
6	Vlera e gjobave nga autoritetet	Vlerë (ALL)	
7	Qarkullimi i punonjësve	Përqindje (%)	
8	Avari/Ndërprerje të programit bazë (core system) të subjektit	(orë:minuta:sekonda)	
9	Numri i rasteve të identifikuara si mashtrim	Numër	
10	Kredi të reja me probleme	Përqindje (%)	

## ANEKSI NR. 2

### UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E TREGUESVE TË PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM

Nr.	Treguesi	Përshkrimi
1	Numri i çështjeve të reja ligjore	Numri i çështjeve të reja ligjore të hapura gjatë periudhës raportuese, në të cilat përfshihet subjekti dhe të cilat përmbajnë elemente të rrezikut operacional. Përfshihen çështjet e tjera ligjore, të cilat nuk përmbajnë elemente të rrezikut operacional.
2	Kostoja e çështjeve ligjore	Vlera e humbjes së pritshme e vlerësuar nga vetë subjekti në lidhje me çështjet ligjore të treguesit nr. 1. Përfshihen kostot e çështjeve të tjera ligjore, të cilat nuk përmbajnë elemente të rrezikut operacional.
3	Ankesat e reja të klientëve	Numri i ankesave të ngritura kundër subjektit nga klientët apo palë të treta gjatë tremujorit, të marra nëpërmjet të gjitha kanaleve të komunikimit të vëna në dispozicion nga subjekti (shkresë formale, e-mail, rrjete sociale etj.). Përfshihen të gjitha ankesat e marra gjatë tremujorit, qoftë ato të mbyllura, të refuzuara apo të hapura në fund të periudhës raportuese (tremujorit).
4	Ankesat e hapura të klientëve	Numri i ankesave të ngritura kundër subjektit nga klientët, grupet e klientëve apo publiku, që rezultojnë ende të hapura në fund të periudhës raportuese (tremujorit).
5	Numri i gjobave nga autoritetet	Numri i gjobave të vendosura subjektit nga autoritetet e ndryshme gjatë tremujorit, të cilat lidhen me veprimtarinë financiare.
6	Vlera e gjobave nga autoritetet	Vlera e gjobave të vendosura nga autoritetet e ndryshme gjatë tremujorit, të cilat lidhen me veprimtarinë financiare.
7	Qarkullimi i punonjësve	Përqindja e qarkullimit të punonjësve të të gjitha kategorive gjatë periudhës raportuese. Përfshihen punonjësit me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. $Q = L / (P) * 100, \quad (P) = (P_0 + P_1) / 2$ ku: Q – qarkullimi i punonjësve; L – numri i punonjësve të larguar gjatë periudhës së raportimit; (P) – numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës së raportimit; P <sub>0</sub> – numri i punonjësve në fillim të periudhës së raportimit; P <sub>1</sub> – numri i punonjësve në fund të periudhës së raportimit.
8	Avari/Ndërprerje të programit bazë (core system) të subjektit	Kohëzgjatja e ndërprerjeve të paplanifikuara të programit bazë të subjektit gjatë tremujorit, e shprehur sipas formatit (orë: minuta: sekonda).
9	Numri i rasteve të identifikuar si mashtrim	Numri i rasteve të identifikuar si mashtrim nga subjekti gjatë periudhës së raportimit.
10	Kredi të reja me probleme	Numri i kredive të reja me probleme ndaj numrit total të kredive të reja të disbursuara gjatë periudhës raportuese (në %). Në numërues përfshihen kreditë e reja me probleme për të cilat nuk kanë kaluar 90 ditë nga momenti i pagesës.

Për raportimin e ngjarjeve të rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, subjekti plotëson regjistrin sipas aneksit nr. 3, duke ndjekur udhëzimet e aneksit nr. 4 të kësaj rregulloreje.

Për ngjarje të cilat kanë zgjatur për më shumë se një periudhë raportuese dhe për rrjedhojë janë raportuar në periudha të mëparshme, subjekti përdor të njëjtin numër identifikimi në qelizën përkatëse të regjistrit dhe informacionin për ngjarjen e paraqet për periudhën raportuese.

Plotësimi i të gjitha fushave të aneksit është i detyrueshëm për çdo ngjarje të regjistruar, përveç fushës “data e rikuperimit” dhe “vlera e rikuperuar”, plotësimi i të cilave do të kryhet kur ka informacion në lidhje me to. Fusha e komenteve rekomandohet, por nuk është e detyrueshme për t’u plotësuar.

Plotësimi i fushave të datës së rikuperimit dhe vlerës së rikuperimit do të shoqërohet me plotësimin e detyrueshëm edhe të fushave “numri i identifikimit të ngjarjes” dhe “përshkrimi i ngjarjes”.

### ANEKSI NR. 3 REGJISTRI I NGJARJEVE TË RREZIKUT OPERACIONAL

Numri i identifikimit	Përshkrimi	Data e ndodhjes (d.m.v)	Data e kontabilizimit (d.m.v)	Shkaku (Niveli 1)	Shkaku (Niveli 2)	Vlera e humbjes bruto/fillestare (lekë)	Data e rikuperimit	Vlera e rikuperuar	Komente

### ANEKSI NR. 4 UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E REGJISTRIT TË NGJARJEVE TË RREZIKUT OPERACIONAL

Kolona	Udhëzime për plotësimin
Numri i identifikimit	Plotësohet numri i identifikimit të ngjarjes i përdorur nga subjekti në regjistrin e brendshëm të ngjarjeve të rrezikut operacional.
Përshkrimi	Plotësohet përshkrimi i çdo ngjarjeje të regjistruar në këtë regjistër. Subjekti nuk duhet të përfshijë informacione të cilat janë subjekt i ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
Data e ndodhjes	Plotësohet data e ndodhjes ose data e fillimit të ndodhjes së ngjarjes, për ato ngjarje të cilat kanë zgjatur efektin e tyre në kohë.
Data e kontabilizimit	Plotësohet data në të cilën ngjarja është regjistruar në pasqyrat financiare të subjektit.
Shkaku (Niveli 1)	Plotësohet një nga opsionet e kolonës “Shkaku i ngjarjes, ndarje sipas nivelit 1” të aneksit nr. 5 të kësaj rregulloreje.
Shkaku (Niveli 2)	Plotësohet një nga opsionet e kolonës “Shkaku i ngjarjes, ndarje sipas nivelit 2” të aneksit nr. 5 të kësaj rregulloreje.
Vlera e humbjes bruto/fillestare (lekë)	Plotësohet humbja fillestare/bruto e çdo ngjarjeje të ndodhur në këtë regjistër. Regjistrohet vlera absolute/pozitive dhe në asnjë rast nuk plotësohen vlera negative.
Data e rikuperimit	Plotësohet data në të cilën është kontabilizuar vlera e rikuperimit.
Vlera e rikuperuar	Plotësohet çdo vlerë e rikuperuar nga humbja fillestare. Vlera e rikuperuar regjistrohet në këtë qelizë dhe nuk prek vlerën e regjistruar në qelizën e humbjes bruto/fillestare.
Komente	Plotësohet me çdo koment të vlefshëm mbi ngjarjen.

**ANEKSI NR. 5**  
**KLASIFIKIMI I NGJARJES SIPAS SHKAKUT, NIVELI 1 DHE 2 I**  
**DETAJIMIT**

Shkaku i ngjarjes, ndarje sipas nivelit 1	Shkaku i ngjarjes, ndarje sipas nivelit 2
Njerëzit/punonjësit	Shkaqe aksidentale (njerëz)
	Mungesë e trajnimit/kompetencës së mjaftueshme
	Nivel i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore
	Role dhe përgjegjësi joefektive
	Komunikim i gabuar
	Kulturë joefektive
	Keqdashje
Dështim i proceseve	Dështim në dizenjimin e procedurës/procesit
	Dështim në implementimin e procedurës/procesit
	Keqadministrim i projekteve/ndryshimeve
	Dështim i qeverisjes
Faktorë të jashtëm	Fatkeqësi natyrore
	Keqdashje
	Terrorizëm/sulme të jashtme (me përjashtim të sulmeve kibernetike)
	Mjedisi (me përjashtim të fatkeqësive natyrore)
	Destabilizim gjeopolitik/ekonomik/social
	Mjedisi rregullator dhe legjislativ
Sistemet	Probleme me funksionalitetin
	Probleme me performancën/kapacitetin
	Mungesë mirëmbajte/suporti
	Padisponueshmëri
	Testim/zhvillim i papërshtatshëm
	Probleme gjatë lancimit/nxjerrjes në përdorim
	Probleme konfigurimi
	Probleme me ruajtjen/memorien dhe shkatërrimin e të dhënave
	Shfrytëzimi i vulnerabiliteteve të lidhura me sigurinë e informacionit
	Çështje të lidhura me teknologjinë
	Probleme planifikimi

## **ANEKSI NR. 6**

### **METODAT DHE TEKNIKAT E ZAKONSHME PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT OPERACIONAL NGA SUBJEKTI PËRFSHIJNË KRYESISHT:**

1. Identifikimin dhe raportimin e ngjarjeve të rrezikut operacional. Çdo punonjës, në momentin e identifikimit të një ngjarjeje operationale, e raporton atë pranë strukturës përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional të subjektit, duke plotësuar gjithë informacionin e nevojshëm.
2. Bazën e të dhënave të ngjarjeve të rrezikut operacional. Struktura përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional mban një bazë të dhënash/regjistër, për të gjitha ngjarjet e rrezikut operacional të subjektit. Kjo bazë të dhënash duhet të përmbajë minimalisht fushat e përshkruara në aneksin nr. 3 të kësaj rregulloreje.
3. Treguesit e paralajmërimit të hershëm. Këta janë tregues performance, tregues rreziku ose/edhe tregues kontrolli që përdoren si mekanizma për monitorimin e ndryshimeve në faktorët e brendshëm të rrezikut, faktorët e jashtëm dhe ambientet e kontrollit të subjektit. Subjekti mbështetet në treguesit rregullatorë të aneksit nr. 1, si dhe në tregues të brendshëm, nëse gjykohet e nevojshme. Treguesit shoqërohen me limite monitorimi të përshtatshme dhe masa përshkallëzuese, me qëllim zbutjen e rreziqeve.
4. Hartëzimin dhe vetëvlerësimin e rreziqeve dhe kontrolleve në fuqi. Ky është një mjet i rëndësishëm për administrimin e rrezikut operacional që ndihmon në kuptimin më të mirë të rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet subjekti. Ky ushtrim zakonisht përfshin këta hapa kryesorë:
  - Identifikimi i rreziqeve: Identifikimi i rreziqeve të mundshme që lidhen me proceset, njerëzit, sistemet dhe faktorët e jashtëm.
  - Vlerësimi i rreziqeve: Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të secilit rrezik për të kuptuar se sa material është ai.
  - Vlerësimi i kontrollit: Vlerësimi i efektivitetit të kontrolleve ekzistuese që janë vendosur për të administruar këto rreziqe.
  - Përcaktimi i masave zbutëse: Nëse rreziku i mbetur është i lartë, përcaktohen masa shtesë për të zvogëluar atë rrezik.

## ANEKSI NR. 7 SHEMBUJ TË NGJARJEVE TË RREZIKUT OPERACIONAL

Lloji i ngjarjes (Niveli 1 i detajimit)	Lloji i ngjarjes (Niveli 2 i detajimit)	Shembuj
Mashtrim i brendshëm	Veprime të paautorizuara	Transaksione të paraportuara (qëllimisht)
		Shpërdorim i fuqisë, aktivitete të paautorizuara
		Ngatërresë/mospërputhje e pozicionit (qëllimisht)
	Vjedhje dhe mashtrim (i brendshëm)	Mashtrim/mashtrim me kreditë/mashtrim me depozitat
		Vjedhje/zhvatje/përvetësim/grabitje
		Keqpërdorim i pronës së subjektit
		Shkatërrim i qëllimshëm i asetëve
		Falsifikim
		Mashtrim me çeqet/mashtrime të tjera të brendshme
		Korrupsion
		Falsifikim/përvetësim i llogarisë
		Mospërputhshmëri me taksat/evazion fiskal
		Shantazhe/ryshfete ose dështim për t'iu përmbajtur rregullave në rastet e përfitimeve (dhurata dhe ftesat e dhëna dhe të marra)
		Keqpërdorim i llogarive (qëllimisht)
Mashtrim i jashtëm	Vjedhje dhe mashtrim (i jashtëm)	Vjedhje/grabitje
		Falsifikim
	Mashtrim me çeqet/mashtrime të tjera të jashtme	
Siguria e sistemit (mashtrim i jashtëm)	Dëmtime nga sulmet kibernetike ( <i>hacking</i> )	
	Vjedhje dhe publikim i të dhënave konfidenciale	
Praktikat e punësimit dhe të sigurisë në punë	Marrëdhëniet me punonjësit	Problematika lidhur me kompensime, përfitime dhe shkeljet nga puna
		Aktivitete (greva, protesta) të organizuara të punonjësve
	Mjedis i sigurt	Detyrime/përgjegjësi të përgjithshme lidhur me sigurinë në punë
		Problematika të rregullores së sigurisë dhe shëndetit
Diversiteti dhe diskriminimi	Kompensime për punonjësit	
Klientët, produktet dhe praktika të veprimtarisë	Përshtatshmëria, publikimi dhe mirëbesimi	Të gjitha llojet e diskriminimit
		Thyerje të rregullave, të mirëbesimit
		Problematika në përshtatshmërinë dhe zbulimin e të dhënave të klientit etj.
		Shkelje e masave mbrojtëse për publikimin e të dhënave të klientëve
		Shkelje e privatësisë
		Praktika të papërshtatshme shitjeje
		Abuzim me të drejtat e llogarisë
		Shpërdorim i informacionit konfidencial
	Detyrim/përgjegjësi e huadhënësit ( <i>lender liability</i> )	
	Praktika të papërshtatshme biznesi dhe tregu	Antitrust
		Praktika të papërshtatshme të biznesit
		Reklamim manipulues
		Tregtim i brendshëm ( <i>insider trading</i> )
		Aktivitet i pa licencuar
	Mangësitë e produktit	Pastrim parash
		Produkte difektoze
	Seleksionimi, sponsorizimi/financimi dhe ekspozimi	Gabime në modele
		Dështim për të investiguar klientin sipas udhëzimeve/rregulloreve/mungesë e njohjes së klientit
	Aktivitete këshilluese	Tejkalim i limiteve të ekspozimit të klientëve
Mosmarrëveshje mbi performancën e aktiviteteve këshilluese		

Dëmtime fizike të aktiveve	Ngjarje katastrofike dhe të tjera	Humbje nga katastrofa natyrore
		Humbje njerëzore nga ngjarje madhore si terrorizëm, vandalizëm etj.
Ndërprerja e aktivitetit dhe dështimi i sistemeve	Sistemet	Hardware
		Software
		Telekomunikacioni
		Dështime të utiliteteve (energjia, transporti etj.)
Ekzekutimi, shpërndarja dhe administrimi i proceseve	Njohja, ekzekutimi dhe mirëmbajtja e transaksioneve	Komunikim i gabuar
		Gabime në regjistrimin e të dhënave, mirëmbajtje dhe gabime në ngarkim ( <i>loading</i> )
		Dështim në përmbushjen e afateve apo përgjegjësi
		Keqfunksionim i modeleve/sistemeve
		Gabime në kontabilizim
		Keqfunksionim i detyrave të tjera
		Dështim gjatë vendosjes në përdorim ( <i>delivery failure</i> )
		Dështim në administrimin e kolateralit
		Mangësi në mirëmbajtjen e të dhënave referuese
	Monitorimi dhe raportimi	Dështim në përputhshmërinë me kërkesat për raportim (raporte financiare ose rregullatore)
		Raportime të jashtme të papërshtatshme (humbje të ndodhura)
	Regjistrimi i klientëve dhe dokumentimi	Pëlqimi i klientit/ mungesa e refuzimit
		Mungesa e dokumenteve ligjore/të paplotësuara
	Menaxhimi i llogarive të klientëve	Akses i paaprovuar dhënë llogarive të klientëve
		Regjistrim i pasaktë i klientëve
		Humbje apo dëmtim i asetëve të klientëve, si pasojë e neglizhencës
Palët e treta tregtare	Performancë e keqe e palëve të treta joklientë	
	Mosmarrëveshje të ndryshme kundrejt palëve të treta joklientë	
Shitësit dhe furnitorët	Mosmarrëveshje me shitësit dhe furnitorët	



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 53, datë 6.11.2024

**PËR  
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN  
“MBI RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË SIPAS SISTEMIT  
RAPORTUES TË UNIFIKUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c”, nenit 27, nenit 70, pika 1, dhe nenit 71 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 47, pika 4, dhe nenit 126, pika 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 43, pika 3, dhe nenit 62, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr.52/2016, datë 19.05.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; si dhe nenit 18, pika 6, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 10.6.2009, e ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) Në nenin 7, pikat 2 dhe 3, hiqet togfjalëshi “dhe vjetore”;
  - b) Në Aneksin 1 “Sistemi i unifikuar i raportimit për bankat dhe degët e bankave të huaja”, bëhen këto ndryshime:
    - i. Shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
      - “Formulari nr. 2.DM: Formulari i raportimit të treguesve kyç të rrezikut operacional”,
      - “Formulari nr. 1.DM: Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit.”,
    - ii. Shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
      - “Formulari nr. 13.DM: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”,
      - “Formulari nr. 14.DM: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut



- operacional*”,
- *“Formulari nr.6/1: Informacion mbi strukturën e aksionerëve në kapitalin e bankës raportuese”;*
- c) Në Aneksin 2 “Sistemi i unifikuar i raportimit për subjektet financiare jobanka”, bëhen këto ndryshime:
- i. Shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
    - *“Formulari nr. 22: Formulari i raportimit të treguesve kyç të rrezikut operacional”;*
    - *“Formulari nr. 1 (frekuencë vjetore) - Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit”;*
  - ii. Shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
    - *“Formulari nr. 23: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”;*
    - *“Formulari nr. 24: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut operacional”;*
    - *“Formulari nr.25: Informacion mbi strukturën e aksionerëve/ ortakëve në kapitalin e subjektit raportues”;*
- d) Në Aneksin 3 “Sistemi i unifikuar i raportimit për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, bëhen këto ndryshime:
- i. Në shkronjën “a”, shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
    - *“Formulari nr. 23: Formulari i raportimit të treguesve kyç të rrezikut operacional”;*
    - *“Formulari nr. 1 (frekuencë vjetore) - Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit”;*
  - ii. Në shkronjën “a”, shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
    - *“Formulari nr. 24: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”;*
    - *“Formulari nr. 25: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut operacional”;*
  - iii. Në shkronjën “c”, shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
    - *“Formulari nr. 29: Formulari i raportimit të treguesve kyç të rrezikut operacional”;*
    - *“Formulari nr. 1 (frekuencë vjetore) - Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit”;*
  - iv. Në shkronjën “c”, shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
    - *“Formulari nr. 30: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”;*
    - *“Formulari nr. 31: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut operacional”;*
- e) Në Aneksin 4 “Sistemi i unifikuar i raportimit për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike”, bëhen këto ndryshime:
- i. Shfuqizohen formularët e mëposhtëm:
    - *“Formulari nr. 19: Raportimi i treguesve kyç të rrezikut operacional”;*
    - *“Formulari nr. 21 (frekuencë vjetore) - Humbjet bruto sipas linjave të biznesit dhe llojeve të ngjarjeve gjatë vitit të fundit”;*
  - ii. Shtohen formularët e mëposhtëm me frekuencë tremujore:
    - *“Formulari nr. 23: Treguesit e paralajmërimit të hershëm”;*
    - *“Formulari nr. 24: Regjistri i ngjarjeve të rrezikut operacional”;*
    - *“Formulari nr. 25: Informacion mbi strukturën e aksionerëve/ ortakëve në kapitalin e subjektit raportues”.*

2. Ngarkohen subjektet e rregullores “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar”, me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare të Bankës së Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 prill 2025.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 54, datë 6.11.2024

**PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES  
“MBI KRITERET DHE METODIKËN PËR ÇAKTIMIN E ÇMIMEVE TË  
SHITJES SË ARTIKUJVE NUMIZMATIKË PËR SHITJE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregulloren “Mbi kriteret dhe metodikën për caktimin e çmimeve të shitjes së artikujve numizmatikë për shitje”, si dhe Aneksin 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.
2. Ngarkohen Departamenti Kërkimeve dhe Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 8.12.2004, “Për miratimin e kriterëve për caktimin e çmimeve të shitjes për monedhat dhe kartëmonedhat metalike, vlera të tjera numizmatike, ambalazhe dhe katalogë”, si dhe të “Metodikës për llogaritjen e çmimeve të tyre”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**

## Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kritereve dhe metodikës që duhen ndjekur në përcaktimin e çmimit të shitjeve për artikujt numizmatikë për shitje të Bankës së Shqipërisë.

## Neni 2 Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Artikuj numizmatikë për shitje" - janë të gjithë artikujt e përfshirë në Fondin Numizmatik për Shitje të Bankës së Shqipërisë, të miratuar për shitje me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së nr. 9, datë 6.2.2008, "Për miratimin e fondit numizmatik të Bankës së Shqipërisë", i ndryshuar;
2. "Vlera kontabël" - është vlera me të cilën secili artikull numizmatik për shitje është regjistruar në bilancin e BSH-së;
3. "Stoku i artikujve numizmatikë për shitje" - është shuma e thjeshtë aritmetike e totalit të inventarit të Arkës Numizmatike për Shitje pranë Departamentit të Kërkimeve dhe të Arkës Stok Numizmatike pranë Departamentit të Emisionit, i miratuar për shitje me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së nr. 9, datë 6.2.2008, "Për miratimin e Fondit Numizmatik të Bankës së Shqipërisë", i ndryshuar;
4. "Katalogë ndërkombëtarë"- janë katalogë ndërkombëtarë të fushës së numizmatikës, ku publikohen monedha dhe kartëmonedha ndërkombëtare, shoqëruar me specifikimet teknike dhe çmimet e tyre, përkatësisht "World Coins" dhe "World Paper Money" të botuar nga Krause Publications INC ose të tjerë të ngjashëm me ta.

## Neni 3 Kategoritë e artikujve numizmatikë për shitje

Kartëmonedhat dhe monedhat metalike për shitje kategorizohen si vijon

1. "Kartëmonedha e monedha metalike me kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë" - të cilat janë miratuar si artikuj numizmatikë për shitje nga Këshilli Mbikëqyrës. Shtesat e Fondit Numizmatik për Shitje me këtë kategori do të miratohen vetëm në rastet e emetimit të serive të reja dhe jo në raste rishtypjeje dhe në sasinë prej 500 copësh për prerje. 500 copët e serisë së parë pasi janë përmbushur nevojat e BSH-së për fondin e paprekshëm dhe të dhuratave;
2. "Kartëmonedha specimene" - janë kartëmonedha që shërbejnë si mostra të kartëmonedhave me kurs ligjor të emetuara nga Banka

e Shqipërisë, të cilat u dërgohen zakonisht bankave qendrore dhe institucioneve financiare bankare për t'i njohur me emetimet e reja. Kjo kategori do të jetë e vlefshme deri në tregtimin e plotë të tirazheve aktualisht të miratuara dhe nuk do të shtohet me emetime të reja specimene;

3. "Kartëmonedha e monedha metalike shqiptare pa kurs ligjor" – janë kartëmonedha dhe monedha të emetuara për qarkullim në vitet 1926-1996 që nuk kanë më kurs ligjor;
4. "Monedha shqiptare përkujtimore" - janë monedha pa kurs ligjor, të shtypura vetëm për qëllime numizmatike;
5. "Buona-lek dhe lekë valutë" - janë kartëmonedha të tregtisë speciale të emetuara nga Banka e Shtetit Shqiptar në vitet 1956, 1965 dhe 1992;
6. "Medaljone përkujtimore" - janë medaljonet e shtypura nga Banka e Shqipërisë për qëllime përkujtimore që lidhen kryesisht me historinë dhe mandatin e Bankës apo ngjarje kombëtare jubilarë. Në ndryshim nga monedhat përkujtimore, medaljonet nuk kanë të konfiguruar vlerë emërore;
7. "Artikuj të tjerë të miratuar për shitje" – janë katalogë, botime të natyrës numizmatike ose historike, apo artikuj të tjerë të miratuar për shitje me urdhër të Administratorit.

#### Neni 4

#### Gjendja fizike e kartëmonedhave dhe monedhave metalike

1. Gjendja fizike e kartëmonedhave për shitje është shkalla e cilësisë të një kartëmonedhe për shitje, bazuar në klasifikimin e International Bank Note Society Grading Standards (Standardet e Vlerësimit të Shoqatës Ndërkombëtare të Kartëmonedhave) për kartëmonedhat. Cilësia e një kartëmonedhe klasifikohet sipas shkallëve më poshtë:
  - a) UNC (*uncirculated*) - e paqarkulluar: është një kartëmonedhë e ruajtur në mënyrë të përsosur, e cila nuk është trajtuar asnjëherë nga autoriteti emetues, një arkëtar banke, koleksionist apo publiku. Letra e saj është e pastër dhe e fortë, nuk ka dekolorime apo njolla. Cepat e saj janë të mprehtë dhe të drejtë, pa asnjë shenjë harkimi apo rrumbullakim. Një kartëmonedhë e paqarkulluar ka letër të pastër dhe të ndritshme, me shkëlqim origjinal;
  - b) aUNC ose AU (*about uncirculated*) - pothuajse e paqarkulluar: është një kartëmonedhë pothuajse e përsosur, me disa shenja të vogla prekjeje apo trajtimi (numërim, lidhje në macetë, magazinim etj.). Mund të mbartë shenja nga numërimi, përtërje nga llastiqet apo lidhëset e macetave, në njërin cep apo në mesin e tyre, por jo tek të dyja këto. Një kartëmonedhë AU

- nuk mund të ketë rrudha. Me rrudhë nënkuptohet një palosje e rezultuar nga lidhja e fortë e saj, e cila ka dëmtuar sipërfaqen e kartëmonedhës. Letra e saj është e pastër dhe e ndritshme, me shkëlqim origjinal. Këndet nuk janë të rrumbullakosura;
- c) EF ose XF (*extremely fine*) - tej mase e shkëlqyer: është një kartëmonedhë tej mase e shkëlqyer, por me shenja të vogla trajtimi (numërim, lidhje në macetë, magazinim etj.). Mund të ketë maksimumi tre palosje të lehta ose një rrudhë të fortë. Letra e saj është e pastër dhe e ndritshme, me shkëlqim origjinal. Cepat mund të jenë shumë pak të rrumbullakosur;
- d) VF (*very fine*) - shumë e shkëlqyer: është një kartëmonedhë shumë e shkëlqyer, por me më shumë shenja trajtimi (numërim, paketim në maceta, magazinim) dhe përdorimi në krahasim me kategorinë XF. Mund të ketë disa palosje vertikale dhe horizontale. Letra mund të ketë papastërti minimale ose njollosje të ngjyrave. Letra është ende relativisht e freskët dhe nuk është e flashkët. Nuk ka grisje në katër anët e saj, megjithëse skajet tregojnë një konsumim të lehtë. Cepat gjithashtu tregojnë konsumim, por nuk kanë rrumbullakim të plotë;
- e) F (*fine*) - e shkëlqyer: është një kartëmonedhë që ka qarkulluar për një kohë të konsiderueshme, me shumë palosje dhe rrudha. Letra nuk është shumë e pisët, por mund të jetë disi e konsumuar. Cepat tregojnë që kartëmonedha është trajtuar shumë (numërim, mbledhje nga qarkullimi, magazinim etj.) dhe kanë grisje të vogla. Grisjet mund të mos shkojnë deri në dizajnin e kartëmonedhës. Nuk ka pikë qendrore për shkak të palosjeve të kartëmonedhës. Ngjyrat janë të qarta, por jo të ndritshme. Mund të ketë më shumë se një vrimë. Pamja e përgjithshme e kartëmonedhës konsiderohet ende e mirë;
- f) VG (*very good*) - shumë e mirë: është një kartëmonedhë e përdorur, por që ruan ende tërësinë e saj. Këndet mund të jenë shumë të konsumuar dhe të rrumbullakosur, mund të ketë vrima të vogla, grisjet mund të shtrihen në dizajn, mund të ketë disa ndryshime të ngjyrave origjinale, mund të ketë njollosje dhe një vrimë të vogël në qendër nga palosja e tepërt. Mund të ketë shenja kapësesh. Kartëmonedha është mjaft e butë, por asnjë pjesë e saj nuk mungon. Një kartëmonedhë në gjendjen VG (*very good*) ka një pamje të përgjithshme jo tërheqëse;
- g) G (*good*) - e mirë: është një kartëmonedhë shumë/konsiderueshëm e përdorur. Dëmtimi i saj vjen nga qarkullimi i zgjatur në kohë dhe përfshin: përthyerje dhe rrudha të shumta dhe të forta, njolla, vrima të vogla dhe/ose vrima të shkaktuara nga kapëset, papastërti, dekolorim, grisje të cepave, vrimë në qendër, cepa të rrumbullakosur dhe një pamje të përgjithshme jotërheqëse. Kartëmonedhat e kësaj kategorie nuk mund të kenë mungesa të një pjese/cope të madhe të tyre. Ato gjithashtu mund të përmbajnë vizatime/shkrime të kryera nga përdoruesit;
- h) Fair - jo e keqe: është një kartëmonedhë krejtësisht e konsumuar, e papastër dhe shumë e përdorur. Përveç defekteve të kategorisë

- G, këtyre lloj kartëmonedhave mund t'i mungojnë pjesë të mëdha. Grisjet e tyre janë më të mëdha se ato të kategorisë G (good) dhe pjesët e errëta (shumë të papastr) të kartëmonedhave Fair janë të konsiderueshme;
- i) (PR) *Poor* – e keqe: është një kartëmonedhë me dëmtime të rënda për shkak të konsumimit, njollave, pjesëve të munguara, shkarravinave, vrimave më të mëdha. Pjesët e saj mund të jenë të ngjitura. Kjo kartëmonedhë mund të shërbejë vetëm për plotësim koleksioni, kur nuk ekzistojnë kopje të tjera të saj.
2. Gjendja fizike e monedhave metalike për shitje është shkalla e cilësisë së një monedhe metalike për shitje, bazuar në sistemin e vlerësimit numerik 70 pikësh (*70-point numerical grading system*), i përdorur nga kompani të specializuara në fushën e numizmatikës. Shkallët e cilësisë për monedhat metalike klasifikohen si më poshtë:
- a) PF (*Proof dhe Mint State*) *Uncirculated*: monedha të prodhuara për koleksionim, në gjendje të përsosur. Monedha në gjendje të shkëlqyer, të cilat nuk kanë shenja përdorimi dhe janë pa gërvishtje apo goditje të dukshme me sy të lirë;
- b) AU *About uncirculated*: Monedha me shenja të lehta përdorimi në jo më shumë se 50% të dizajnit. Detaje të plota me dëmtime minimale;
- c) XF *Extra fine* - VF *Very fine* - F *Fine*: Monedhë me dëmtime të lehta të dukshme, por legjenda dhe numra të pa dëmtuar;
- d) VG *Very Good* - G *Good*: Monedha me dëmtime të dukshme, legjendat dhe numrat lexohen, por janë disi të ngrëna;
- e) AG *About Good* –FR- *Fair* - PO1 *Poor*: Monedha të dëmtuara, por me detaje të mjaftueshme për të identifikuar prerjen dhe vitin e emetimit, me buzë të dëmtuara dhe të sheshta.

## Neni 5

### Kriteret e caktimit të çmimeve të shitjes për artikujt numizmatikë për shitje

1. Çmimi i miratuar për shitjen e artikujve numizmatikë llogaritet si shumatore aritmetike e çmimit të tregtimit, zbritjeve në rastet kur ka të tilla, dhe tatimit të vlerës së shtuar (TVSH).
2. Çmimi në tregtim është vlera më e lartë ndërmjet çmimit në prodhim, çmimit të katalogut dhe çmimit të metalit të çmuar, e shprehur në Lek.
3. Çmimi në prodhim është çmimi i artikullit numizmatik, i llogaritur sipas vlerës së regjistruar të artikullit në bilancin e BSH-së. Ai është i barabartë me shumatoren aritmetike të vlerës kontabël dhe fitimit, përveç rasteve më poshtë:
  - a) Për kategorinë "Kartëmonedha e monedha metalike me kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë", në llogaritjen

- e çmimit në prodhim nuk aplikohet fitimi.
- b) Për kategorinë "Kartëmonedha specimene", çmimi në prodhim nuk llogaritet.
4. Çmimi i katalogut është çmimi i çdo artikulli numizmatik për shitje të publikuar në katalogët ndërkombëtarë të numizmatikës. Ai është i barabartë me çmimin e përcaktuar në katalogun përkatës më të fundit të publikuar për shkallën e cilësisë që i korrespondon artikullit. Përjashtim nga ky rregull bëjnë:
- a) kategoritë e artikujve numizmatikë për shitje "Kartëmonedha e monedha metalike shqiptare pa kurs ligjor" dhe "Buona-lek dhe lekë valutë", për të cilat aplikohet zbritje prej 15% për çdo shkallë cilësie;
- b) Për artikujt numizmatikë për shitje që nuk janë publikuar ose nuk gjenden në katalogë, çmimi i katalogut do të jetë i barabartë me 0 (zero). Përjashtim nga ky rregull bëjnë kartëmonedhat specimene, të cilat në rastet kur nuk janë publikuar në katalogë vlerësohen me çmimin e specimentit më të afërt në prerje dhe në vit;
- c) Në rastet kur çmimi për shkallët e cilësisë sipas përkufizimeve në shkronjat "l" dhe "m", neni 2, të këtij vendimi mungojnë, çmimi i shitjes së artikujve numizmatikë përcaktohet i diferencuar ndaj çmimit në katalog, duke zbritur me 10% të çmimit për cilësinë maksimale për çdo rënie në kategori për gjashtë kategoritë e para dhe nga 5% për çdo kategori tjetër.
5. Çmimi i metalit të çmuar është çmimi i artikullit numizmatik në metal të çmuar, i llogaritur për vlerën e metalit dhe përcaktohet vetëm për artikujt numizmatikë në metal të çmuar. Ky çmim është i barabartë me vlerën, e shprehur në Lek, të përfutur nga shumëzimi i peshës në gram të artikullit numizmatik me çmimin për gram të metalit të tij, të listuar në bursën ndërkombëtare, të cilës i referohet Banka e Shqipërisë, në ditën e fundit të punës së muajit. Kursi i këmbimit që aplikohet është ai i ditës së fundit të punës së muajit.

## Neni 6 Fitimi

Fitimi i Bankës së Shqipërisë nga shitja e artikujve numizmatikë për shitje, përcaktohet në masën 10% të çmimit në tregtim.

## Neni 7 Shitja me shumicë dhe zbritjet

1. Shitje me shumicë konsiderohet shitja e artikujve numizmatikë në sasi  $\geq 100$  copë në letër apo metal të thjeshtë. Shitja me shumicë e monedhave dhe medaljoneve në metal të çmuar do të konsiderohet



për sasi  $\geq 10$  copë. Në rastet e shitjes me shumicë të artikujve numizmatikë për shitje, do të aplikohet një zbritje e barabartë me 5% të çmimit të shitjes.

2. Çmimi i tregtimit zbritet me 40% në rastet kur inventari/stoku i një artikulli numizmatik për shitje është më shumë se 5% e totalit të sasisë së fondit të miratuar për shitje, 15 vite pas miratimit të tij, dhe kur shitja e stokut të mbetur mund të realizohet në jo më pak se 5 vite (e llogaritur si pjesëtim i thjeshtë i stokut me shitjet mesatare të tri viteve të fundit çdo herë që miratohen çmimet). Përjashtim nga ky rregull janë rastet kur çmimi del më i vogël ose i barabartë me vlerën kontabël. Në këto raste, artikulli shitet me 10% fitim mbi vlerën kontabël.
3. Përjashtim nga rregullat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 më sipër, përbën kategoria "Kartëmonedha e monedha metalike me kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë". Çmimi i miratuar për shitjen e këtyre objekteve është i barabartë me vlerën nominale plus tatimin e vlerës së shtuar (TVSH). Për këtë kategori nuk aplikohen zbritje.

### **Neni 8** **Caktimi, miratimi dhe shpallja e çmimeve**

1. Çmimet përcaktohen në Lek dhe rrumbullakosen në shifrën më të plotë nga lart (pa shifra pas presjes dhjetore).
2. Banka e Shqipërisë miraton çdo janar, çmimet për shitjen e artikujve numizmatikë.
3. Përjashtim nga përcaktimet e pikës 2 më sipër bëjnë çmimet e shitjes për artikujt numizmatikë për shitje me metal të çmuar, çmimi i të cilëve llogaritet çdo muaj.
4. Çmimet e shitjes së artikujve numizmatikë për shitje, llogaritur sipas metodikës bashkëlidhur në Aneksin nr. 1, propozohen nga Departamenti i Kërkimeve dhe miratohen nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë. Për çmimet e miratuara informohet Departamenti i Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës.
5. Çmimet e miratuara për shitjen e artikujve numizmatikë për shitje publikohen në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë pas miratimit dhe përditësohen pas çdo ndryshimi.

**KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS**

**GENT SEJKO**

**ANEKS 1**  
**METODIKA PËR LLOGARITJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES TË ARTIKUJVE NUMIZMATIKË PËR SHITJE**  
**(Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 54, datë 6.11.2024)**

I. Për llogaritjen e çmimeve në prodhim

Artikulli Numizmatik	Vlera kontabël / GL në ALL	Fitimi në % (+) ndaj Vlerës kontabël / GL	Çmimi në prodhim, në Lek
	1	2	$3 = 2 + 1$

II. Për llogaritjen e çmimeve të katalogut

Artikulli Numizmatik	Shkalla e cilësisë	Çmimi në katalog në Usd	Diferenca në % (-) ndaj çmimit të katalogut	Çmimi i Katalogut në Usd	Çmimi i Katalogut në Lek
	1	2	3	$4 = 2 - (2 \times 3)$	$5 = 4 \times \text{kursin}$

III. Për llogaritjen e çmimeve të metalit

Artikulli Numizmatik	Materiali AG & AU	Pesha e monedhës në gr/ 1 copë	Pastërtia për/1000	Pesha neto në gr/1 copë	Pesha e shprehur në ONC	Vlera për peshën në USD	Vlera për peshën në ALL	Çmimi i metalit
1		2	3	$4 = 2 \times 3$	$5 = 4 * \text{ONC}$	$6 = 5 \times \text{Vlerën në USD}$	$7 = 6 \times \text{Kursi}$	8

IV. Për llogaritjen e çmimit të miratuar për shitjen e artikujve numizmatikë

Artikulli numizmatik	Viti i miratimit si Fond shitjeje (FSH)	Distanca (në vite) nga miratimi si FSH	Sasia e miratuar si FSH në copë	Sasia e mbetur pa shitur në copë	Sasia e mbetur në % ndaj miratimit si FSH	Çmimi në prodhim	Çmimi në katalog	Çmimi i metalit	Çmimi i tregtimit	Çmimi i artikujve me 40% zbritje	Çmimi i miratuar	Çmimi i miratuar me shumicë
	1	2	3	4	$5 = (4/3) \text{ në } \%$	6	7	8	$9 = (\text{max ndërmjet } 6,7,8)$	10	11	$12 = 9 * 0.95$



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 56, datë 6.11.2024

**PËR  
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E  
MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS BANKËS SË SHQIPËRISË  
DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE (EIB)**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; neneve 28 dhe 29 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe bazuar në propozimin e Guvernatorit dhe të Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Zëvendësguvernatoren e Dytë, zj. Natasha Ahmetaj, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (EIB), e cila synon mbështetjen teknike dhe zhvillimin e kapaciteteve për implementimin e financave të gjelbra dhe për administrimin e rreziqeve financiare të lidhura me klimën, në përputhje me objektivat e Strategjisë së Gjelbër të Bankës së Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM  
Nr. 57, datë 6.11.2024

**PËR**  
**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS**  
**NR. 81, DATË 15.11.2006 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES**  
**"PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT NË BANKËN E SHQIPËRISË", I**  
**NDRYSHUAR"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43 shkronjat "c" dhe "g", nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit nr. 36/2020, datë 16.4.2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1170, datë 24.12.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 23.10.2024 "Për miratimin e rregullore "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë"; dhe me propozim të Departamentit të Administrimit dhe Kryetarit të Entit Prokurues,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 81, datë 15.11.2006, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - 1.1 Në nenin 3, paragrafi i parë numërohet pika 1.
  - 1.2 Pas pikës 1 të nenit 3, shtohet pika 2 me përmbajtje si vijon:  
*"Përfashtimisht nga përcaktimet në pikën 1 të këtij neni, për prokurimet në fushën e sigurisë do të zbatohen procedurat dhe kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 36/2020, datë 16.4.2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë" dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe nenet 54/1, 54/2, 54/3 dhe 54/4 të kësaj rregulloreje."*

1.3. Paragrafi i dytë ekzistues në nenin 3 rinumërohet pika 3.

1.4. Shkronja "gj" e nenit 10 shfuqizohet.

1.5. Në nenin 13, bëhen ndryshimet si vijon:

- a. Në fjalinë e parë, hiqet togfjalëshi "në të paktën dy gazeta vendase me tirazhin më të madh dhe në tre numra të njëpasnjëshëm të tyre,";
- b. Në fjalinë e dytë, zëvendësohet togfjalëshi "nga data e fundit e shpalljes së njoftimit në gazetë" me togfjalëshin "nga data e shpalljes së njoftimit në Website-in e Bankës së Shqipërisë";

1.6. Në nenin 18 "Mënyra e Dytë", shkronja "a" e rregullores, shtohen në fund, fjalitë me përmbajtje si më poshtë:

*"Zarfat e ofertave teknike dhe ekonomike, firmosen në të dy anët e hapjes së zarfit, nga anëtarët e Komisionit të Prokurimit, në prezencë të kandidatëve të paraqitur. Ky fakt evidentohet edhe në procesverbalin përkatës.*

*Zarfat e ofertës teknike dhe ekonomike depozitohen në dosjen e prokurimit, deri në hapjen e tyre sipas fazave të procedurës."*

1.7. Në fjalinë e tretë të nenit 20, zëvendësohet togfjalëshi "njoftimi në gazetë" me togfjalëshin "njoftimi në Website-in e Bankës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik":

1.8. Në shkronjën "b" të neneve 26 dhe 27, hiqet togfjalëshi "dhe jo nëpërmjet njoftimit në gazetë":

1.9. Në nenin 35 shtohen dy paragrafë të fundit me përmbajtje si më poshtë:

*"Në rast anulimi të procedurës së prokurimit, dokumentacioni për kualifikim i paraqitur nga kandidatët mund të konsiderohet dhe të merret për bazë nga Komisioni i Prokurimit për të njëjtën procedurë prokurimi dhe sa herë ajo të përsëritet, me kushtin që ky dokumentacion (ose pjesë të tij) të jetë akoma i vlefshëm dhe brenda afateve të kërkuara.*

*Në çdo rast, kualifikimi i secilit prej kandidatëve pjesëmarrës do të bëhet duke evidentuar në procesverbalin e mbledhjes, sipas rastit, prezencën e dokumentacionit të ri të paraqitur, të atij që mungon ose që nuk është në përputhje me kërkesat për kualifikim, si dhe të dokumentacionit të vlefshëm të paraqitur në procedurën/at e mëparshme të anuluar/a, që vlerësohet të merret për bazë nga Komisioni i Prokurimit."*

1.10. Në nenin 41 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:

"2/1. Kur procedura e prokurimit anulohet dhe përsëritet dhe sërish rezulton vetëm një kandidat apo një ofertë/kuotim i vlefshëm, Komisioni i Prokurimit nuk anulon procedurën, por vijon fazat e tjera të procedurës vetëm me një kandidat."

- b) Në pikën 3, fjalia e parë ndryshon me përmbajtje si më poshtë:  
"Përfundimisht nga përcaktimet në pikën 2/1 të këtij neni, kur edhe pas përsëritjes si më sipër të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit rikonstaton ekzistencën e njërit prej rasteve të anulimit, bën sugjerimin dhe argumentimin përkatës për Kryetarin e Entit Prokurues."

1.11 Pas nenit 54, shtohen Kreu VIII/1 dhe nenet 54/1, 54/2, 54/3, 54/4 me përmbajtje si vijon:

## **"KREU VIII/1 PROKURIMET NË FUSHËN E SIGURISË**

### **Neni 54/1**

#### **Strukturat për ndjekjen e procedurave të prokurimit në fushën e sigurisë**

1. Strukturat për ndjekjen e procedurave të prokurimit në fushën e sigurisë janë:
  - i. Njësia e Prokurimit (rast pas rasti);
  - ii. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (rast pas rasti);
  - iii. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (në fillim të vitit).

Njësia e Prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ngrihen me urdhër të Zëvendësgubernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, në cilësinë e Kryetarit të Entit Prokurues dhe me propozim të Departamentit të Administrimit.

2. Zëvendësgubernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë, në cilësinë e Kryetarit të Entit Prokurues, është autoriteti kompetent për miratimin e:
  - i. Urdhrit të Prokurimit në fushën e sigurisë;
  - ii. Njoftimit të fituesit, në vijim të procedurës së prokurimit në fushën e sigurisë;
  - iii. Anulimit të procedurës së prokurimit në fushën e sigurisë, përveç rasteve kur anulimi është vendosur nga Komisioni i Prokurimit Publik;
  - iv. Pezullimit të procedurës së prokurimit në fushën e sigurisë;
  - v. Kontratës që do të lidhet në vijim të procedurës së prokurimit në fushën e sigurisë;
  - vi. Urdhrit për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit;
  - vii. Akteve dhe njoftimeve të cilat, në bazë të Ligjit nr. 36/2020,

datë 16.4.2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë" dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, janë kompetencë e titullarit të autoritetit kontraktor.

3. Njoftimet/komunikimet e Njesisë së Prokurimit në përmbushje të funksioneve të saj, drejtuar autoriteteve/subjekteve të interesuara, jashtë Bankës së Shqipërisë, do të përcillen nga Drejtori i Departamentit të Administrimit.
4. Departamenti i Administrimit përcjell në Agjencinë e Prokurimit Publik, njoftimet për publikim.

### **Neni 54/2** **Kërkesat për prokurim në fushën e sigurisë**

1. Procedurat e prokurimit në fushën e sigurisë nisin në çdo rast, në vijim të kërkesës për prokurim të paraqitur nga departamenti përkatës kërkues i Bankës së Shqipërisë. Në kërkesë do të përfshihen të paktën:
  - i. Kërkesat e qarta dhe të plota lidhur me objektin e prokurimit që kërkohet të realizohet, të shoqëruara me argumentimin përkatës nga departamenti kërkues, në lidhje me natyrën në fushën e sigurisë, së objektit që kërkohet të prokurohet.
  - ii. Kërkesat dhe/ose specifikimet teknike të plota, të hartuara me përgjegjësi në bazë të nevojave të Bankës së Shqipërisë;
  - iii. Koha brenda të cilës është i nevojshëm përfundimi i prokurimit për Departamentin që bën kërkesën;
  - iv. Fondi i nevojshëm i planifikuar në zërat e buxhetit të vitit ushtrimor dhe/ose afatmesëm (në rastin e objekteve me kohëzgjatje më shumë se një vit kalendarik);
  - v. Lista e punonjësve të departamentit ose të strukturës, prej të cilës do të mund të zgjidhen anëtarët përkatës të Njesisë së Prokurimit dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
  - vi. Miratimi i Këshillit Mbikëqyrës për realizimin e objektit të prokurimit për një kohëzgjatje më shumë se një vit kalendarik.

### **Neni 54/3** **Përlllogaritja e fondit limit për procedurat në fushën e sigurisë**

1. Për procedurat e thjeshtuara të prokurimit në fushën e sigurisë, përlllogaritja e fondit limit bëhet nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, pas paraqitjes së Kërkesës për Prokurim.
2. Për procedurat e tjera të prokurimit, jo të thjeshtuara, përlllogaritja e fondit limit bëhet nga Sektori i Prokurimeve i Departamentit të Administrimit, pas paraqitjes së Kërkesës për Prokurim dhe përpara se të ngrihet Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

### Neni 54/4

#### *Lidhja e kontratës në fushën e sigurisë dhe ndjekja e saj*

1. Në vijim të përfundimit të afatit të ankimimit dhe njoftimit të fituesit për lidhjen e kontratës, Departamenti i Administrimit negocion për lidhjen e kontratës ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe subjektit fitues.
2. Departamenti i Administrimit, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga ndjekësi i kontratës, raporton në vazhdimësi tek Kryetari i Entit Prokurues mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.
2. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, në mbështetje të rregullores "Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", miraton me akt të veçantë detyrat e strukturave përkatëse në Bankën e Shqipërisë, për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 58, datë 20.11.2024

**PËR  
MIRATIMIN E "STRATEGJISË AFATMESME TË ZHVILLIMIT  
TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR PERIUdhËN 2025-2027"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozim të Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2025-2027, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kabineti i Guvernatorit të monitorojë zbatimin e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2025-2027, nga departamentet dhe njësitë e tjera organizative të Bankës së Shqipërisë, si dhe t'i raportojë Guvernatorit.
3. Departamentet dhe njësitë e tjera organizative të Bankës së Shqipërisë të raportojnë në Kabinetin e Guvernatorit për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2025-2027.
4. Ngarkohen të gjitha departamentet dhe njësitë e tjera organizative të Bankës së Shqipërisë, për të cilat në Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2025-2027 janë përcaktuar detyra konkrete, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 janar 2025.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 61, datë 20.11.2024

**PËR  
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 4,  
DATË 24.1.2024 "PËR RISHTYPJEN E MONEDHAVE METALIKE  
SHQIPTARE ME KURS LIGJOR, ME PRERJE 50 LEKË DHE 20 LEKË"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33, pikat 2 dhe 3, nenit 36, nenit 39, pika 2, dhe nenit 43, shkronjat "c" dhe "d" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 16 të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr. 133, datë 7.12.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 24.1.2024, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

*"Pika 1 në Aneksin 1 "Përcaktimet për rishtypjen e monedhës shqiptare me kurs ligjor, prerja 50 Lekë", pjesë përbërëse e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 24.1.2024, të ndryshohet sipas Aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi."*

2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të Aneksit 1, i cili përmban informacion të klasifikuar jopublik, si "sekret bankar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**GUVERNATORI**

Nr. 4790 prot.

Tiranë, më 21.11.2024

**VENDIM**  
Nr. 4790, datë 21.11.2024

**PËR**  
**DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE**  
**SHTESË TË SHËRBIMIT TË INICIMIT TË PAGESËS DHE TË SHËRBIMIT**  
**TË INFORMIMIT TË LLOGARISË NGA INSTITUCIONI I PARASË**  
**ELEKTRONIKE "EASYPAY" SH.P.K.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; neneve 64, pika 1, shkronja "a", 70 dhe 71 të rregullores "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave", miratuar me vendimin nr. 59, datë 24.11.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; të pikës 10, të shtojcës 3 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr.36, datë 26.05.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; pasi u njoha me kërkesën e institucionit të parasë elektronike "Easypay" sh.p.k., dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSA:

1. Dhënie e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarive shtesë (i) të shërbimit të inicimit të pagesës dhe (ii) të shërbimit të informimit të llogarisë nga ana e institucionit të parasë elektronike "Easypay" sh.p.k.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe përditësimin e aneksit të licencës së subjektit.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**GUVERNATOR**

**GENT SEJKO**

## **TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 1, JANAR 2024**

1. Licencë nr. 55, datë 3.11.2023, "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 2, datë 24.1.2024, për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Sistemet e Pagesave"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 24.1.2024, "Për miratimin e disa ndryshimeve në kontratën tip për riblerjen e titujve"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 5, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë "Për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtime dhe për qëllime numizmatike për 2024-2029""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 6, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare, 2024-2026"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 7, datë 24.1.2024 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Akademisë së Sigurisë"

## **TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 2, SHKURT 2024**

1. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. 644, datë 6.2.2024 "Për pezullimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Micro Credit Albania""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 7.2.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.10, datë 7.2.2024, "Për miratimin e udhëzimit "Për raportimin e incidenteve madhore"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.11, datë 7.2.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 12, datë 7.2.2024, "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e krijimit dhe shtypjes së monedhave dhe kartëmonedhave pa kurs ligjor, përkujtime për qëllime numizmatike, dhe medaljoneve përkujtime nga Banka e Shqipërisë""

## TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 3, PRILL 2024

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 15, datë 6.3.2024 "Për një ndryshim në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 16, datë 6.3.2024 "Për shtypjen e monedhës metalike përkujtimore, për qëllime numizmatike, me tematikë "100 vjet Banka e Shqipërisë, 1925-2025""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 17, datë 20.3.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 18, datë 20.3.2024 "Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023"
5. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 1481, datë 2.4.2024 "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 21, datë 3.4.2024 "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro""
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 24, datë 3.4.2024 "Për rishtypjen e kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor, me prerje 200 Lekë dhe 500 Lekë"

## TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 4, QERSHOR 2024

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 26, datë 8.5.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 27, datë 8.5.2024 "Për "Një ndryshim në vendimin nr. 36, datë 25.6.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e procedurës së veçantë të prokurimit për përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të fondit të pensionit suplementar", i ndryshuar""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 28, datë 8.5.2024 "Për miratimin e "Dokumentit të politikës së investimit të fondit të pensionit në Bankën e Shqipërisë""
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 29, datë 8.5.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 30 datë 8.5.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për sigurinë e informacionit""
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 31, datë 8.5.2024 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 23.3.2023"



- "Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhës përkujtimore, që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2023""
7. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2302, datë 23.5.2024 "Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Micro Credit Albania" SH.P.K."
  8. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2303, datë 23.5.2024 "Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Final" SH.P.K."
  9. Urdhër i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2454, datë 4.6.2024 "Për hedhjen në qarkullim të monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor, me vlerë nominale 5 Lekë"
  10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 32, datë 5.6.2024 "Për miratimin e lirimimit nga detyra të drejtorit të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme të Bankës së Shqipërisë"
  11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 33, datë 5.6.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka""

#### **TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 5, KORRIK 2024**

1. Vendim i Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 5427, datë 28.12.2023 "Për miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme"
2. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2819, datë 27.6.2024
3. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2820, datë 27.6.2024
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 34, datë 3.7.2024 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 35, datë 3.7.2024 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për politikën dhe mënyrën e administrimit të arit""
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 36, datë 3.7.2024 "Për miratimin e një ndryshimi në rregulloren "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shyerjes së titujve (AFISaR)""
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 39, datë 3.7.2024 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së konfidencialitetit midis bankave qendrore në kuadër të pjesëmarrjes në projektin DCTF-ii (The Data Collection Task Force-ii) të rrjetit "Historia monetare e Evropës Juglindore (South-Eastern European Monetary History Network - SEEMHN)"

## TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 6, GUSHT 2024

1. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2680, datë 20.6.2024 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren nr. 3762, datë 18.7.2016 "Për kompensimin e depozitave të siguruara""
2. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2852, datë 28.6.2024 "Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit"
3. Vendim i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 5024, datë 17.7.2024 "Për pezullimin e ushtrimit të veprimtarive financiare dhe marrjen e masave mbikëqyrëse për Shoqërinë e Kursim-Kreditit "Rrushkull One"
4. Vendim i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 5416, datë 2.8.2024 "Për pezullimin e ushtrimit të veprimtarive financiare të shoqërisë së kursim kreditit "Perlat" dhe përfundimin e procesit të bashkimit me përthithje me shoqërinë e kursim-kreditit "Rrushkull One""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 40, datë 7.8.2024 "Për miratimin e raportit tremujor të politikës monetare"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 41, datë 7.8.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 42, datë 7.8.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka""
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 43, datë 7.8.2024 "Për miratimin e rregullores "Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve""

## TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 7, NËNTOR 2024

1. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr.prot 4036, datë 1.10.2024 "Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 46, datë 2.10.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 47, datë 2.10.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka""
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 48, datë 2.10.2024 "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare e financiare, dhe për transportin e vlerave monetare""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 50, datë 6.11.2024 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore

- në Bankën e Shqipërisë”
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 51, datë 6.11.2024  
“Për miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut operacional nga bankat,  
institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike””

